



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3715/6 prot.

Datë 09.01.2026

V E N D I M

Nr. 37/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.01.2026 me:

Objekt: Mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TOP OIL” ShPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-70962-12-03-2025, me objekt “Vajra dhe Lubrifikant për automjete”, me fond limit: 2,894,167 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.12.2025 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Ankimues: Operatori ekonomik “TOP OIL” Sh.A, me Nipt K16604717F.
Adresa: Peshkopi, Dibër.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
Adresa: Rr. “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i
Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, informacionin e autoritetit kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.12.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-70962-12-03-2025, me objekt “Vajra dhe Lubrifikant për automjete”, me fond limit: 2,894,167 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.12.2025 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, dhe në datën 23.12.2025, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

1. TREG AUTO Sh.A	me vlerë	1,447,300	L. pa TVSh	Skualifikuar
2. ELBA-OIL 2015 Sh.A	“	1,572,750	“	Skualifikuar
3. TRONIX Sh.A,	“	1,663,150	“	Skualifikuar
4. TOP-OIL Sh.A.	“	2,444,500	“	Skualifikuar
5. NAZO OIL Sh.A	“	2,600,250	“	Skualifikuar
6. A R B L E V Sh.P.K	“	2,605,250	“	Skualifikuar
7. SAHORA Sh.P.K	“	2,698,771	“	Skualifikuar
8. Alked Kopaçi P.F	“	2,741,750	“	Skualifikuar

II.3. Më datë 24.12.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin anulimi të procedurës.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6216, datë 27.12.2025 dhe me Nr. 3715/2025 Prot., date 29.12.2025 e operatorit ekonomik “TOP OIL” ShA, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-70962-12-03-2025, me objekt “Vajra dhe Lubrifikant për automjete”, me fond limit: 2,894,167 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.12.2025 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TOP OIL” ShPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe Formular për Publikim me Nr. 3715/1 prot., datë 29.12.2025.

II.6. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë në sistem shkresën me nr.45 Prot., datë 06.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3715/2, datë 07.01.2026 si edhe shkresën ardhur me shërbim postar me nr.45/1 Prot., datë 06.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3715/3, datë 08.01.2026, me objekt: “Kthim përgjigje ankesës”, drejtuar KPP-së dhe Operatorit ekonomik ankimues.

II.6.1. Referuar Vendimit të KSHA-së me nr.09, datë 06.01.2026, Autoriteti kontraktor ka vendosur animimin e plotë të ankesës.

II.7. Në përputhje me **nenin 113** të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, referuar dosjes administrative knstatohet se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuar në lidhje me ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TOP OIL” ShPK me pretendimet si vijon:

[...] *Oferta e dorëzuar nga shoqëria jone, me vlerë të ofertuar: 2,444,500 Leke pa TVSH është skualifikuar nga KVO-ja në autoritetin kontraktor për arsye si më poshtë vijnë:..- nuk plotëson kriterin teknik pasi: 1. Ka paraqitur katalog i cili nuk përmbush disa nga të dhënat e specifikimeve teknike të kërkuesit. 2. Nuk ka paraqitur analizat. Ne katalog mungojnë disa prej elementëve të kërkuara të specifikimeve teknike. Analizat e vajit në disa zëra nuk*

përputhen me specifikimet teknike. Arsytet e mësipërme për skualifikim nuk qëndrojnë, janë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentat e tenderit, objekt i këtij ankimi, dhe si të tilla këto arsye për skualifikim të dhëna nga KVO-ja duhet të shfuqizohen dhe në përfundim oferta e araqitur nga shoqëria jonë duhet të kualifikohet...

Në përmbushje të kriterëve 2.2.2, 2.2.3 dhe 2.2.5, ofertuesi TOP OIL SH.A si pjesë të ofertës së tij ka dorëzuar në SPE dokumentat e emërtuara si më poshtë vijojnë: - Formulari_Përmbledhes_i_Vetedeklarimit_APR.pdf, dokument në të cilin gjendet, Formulari përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 9 të DT-së, ku në pjesën III Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, gjendet A: DEKLARATA (në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës, ku është deklaruar se, në cilësinë e OE, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, sic udhëzohet në dokumentet e tenderit dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.. duke përzgjedhur pergjigjen po.... Pavarësisht sa më sipër, nga ana e shoqërisë tonë, janë paraqitur si pjesë e ofertës në SPE, për të 12 produktet e kërkuara katalogët ose fragmentet respektive të katalogëve të prodhuesve të tyre ku vërtetohet se mallrat e ofertuara plotësojnë të gjitha kërkesat e AK-së, të përcaktuara në shtojcën e specifikimeve teknike.... Produktet e ofertuara nga ana jonë ë plotësojnë të gjitha kërkesat minimale të specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK-ja ose janë edhe më cilësore se ato të kërkuara nga AK-ja. Mjafton të verifikohen të dhënat e fletë analizave të hedhura në SPE së pjesë e ofertës tonë për këtë procedurë prokurimi dhe vërtetohet qartësisht se, ato i plotësojnë të gjitha kërkesat e specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.KVO mund të kërkonte sqarime për paqartësi të dokumenteve të ofertes...

Kerkojme sa më sipër:

1- Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria TOP OIL ShA, në procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me objekt “Vajra dhe Lubrifikant për automjete”, 2-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për anulimin e procedurës së prokurimit dhe shpalljen e shoqërisë TOP OIL SHA, fituese të kësaj procedure prokurimi.[...]

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur pranimin e ankesës.

2. Arsyetimi

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se mospërputhjet e evidentuara në fazën e vlerësimit të ofertave lidhen me natyrën dhe mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit teknik, si dhe me nevojën për një interpretim më të integruar të specifikimeve teknike në raport me të dhënat e analizave të vajit.

Nga shqyrtimi i plotë i ankimit dhe dokumentacionit shoqërues rezulton se këto mospërputhje kanë karakter formal dhe nuk përbëjnë mangësi thelbësore në kuptim të legjislacionit për prokurimin publik, të tilla që të justifikojnë skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues.

Në këtë kuadër, Komisioni çmon se këto elemente kanë karakter plotësues dhe nuk përbëjnë mangësi që çënojnë përmbushjen e kërkesave kryesore të objektit të prokurimit, duke mos ndikuar në përputhshmërinë funksionale të ofertës së operatorit ekonomik.

3. Vendimi / Propozimi

Në këto rrethana, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit administrativ dhe teknik të procedurës, çmon se është e nevojshme vijimi i procedurës në përputhje me konstatimet e mësipërme dhe, për rrjedhojë, i propozon titullarit të Autoritetit Kontraktor rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "TOP OIL" ShPK, si dhe kthimin e procedurës në fazën e rivlerësimit të ofertës së këtij operatori ekonomik.

Referuar për gjithë sa më sipër Komisioni i shqyrtimit të ankesës:

VENDOSI:

- Pranimin e ankesës së subjektit "Top Oil" shpk
- Propozimin e shfuqizimit të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "TOP OIL" ShPK
- Kthimin për rivlerësim të ofertës së operatorit ekonomik "TOP OIL".

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse

operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Pra sa më sipër konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “TOP OIL” SH.A, për shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e tij, në procedurën e prokurimit sipërcituar, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit.

Komisioni në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 dhe të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “TOP OIL” SH.A për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70962-12-03-2025, me objekt “Vajra dhe Lubrifikant për automjete”, me fond limit: 2,894,167 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.12.2025 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “TOP OIL” Sh.A për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70962-12-03-2025, me objekt “Vajra dhe Lubrifikant për automjete”, me fond limit: 2,894,167 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.12.2025 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat duke kualifikuar operatorin ekonomik “TOP OIL” Sh.A sipas vendimmarrjes së KSHA-së.

3. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TOP OIL” Sh.A.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro

